



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 88, datë 28.04.2022<sup>1</sup>**

**UDHËZIM**

**MBI**

**PRITSHMËRITË RREGULLATORE PËR TREGUN E SIPËRMARRJEVE TË  
INVESTIMEVE KOLEKTIVE (SIK) PËR PERIUdhËN PRILL-QERSHOR 2022**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 3, 12, dhe 14, pikat 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

Duke konsideruar rritjen e luhatshmërisë në tregjet ndërkombëtare të titujve, ndikimin në tregun vendas të ndryshimit të normave të interesit si dhe ekspozimin që Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive (SIK), të licencuara në Republikën e Shqipërisë, kanë në këto tregje;

Duke vlerësuar masat e marra nga shoqëritë administruese në kuadër të administrimit të portofoleve dhe administrimit të riskut të SIK dhe kujdesin e shtuar që duhet treguar nga ana e këtyre shoqërive ndaj treguesve teknikë dhe financiarë të SIK, si likuiditeti, rezultatet e stress testeve dhe niveli i treguesit sintetik të përfitimit dhe rrezikut;

**Udhëzon shoqëritë administruese të SIK që:**

- Të rrisin frekuencën e raportimit në Autoritet, duke dërguar një herë në javë informacionin për shlyerjet neto;
- Të raportojnë çdo muaj në Autoritet treguesin e likuiditetit të SIK që kanë nën administrim;

<sup>1</sup> Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 136, datë 29.07.2022

<sup>2</sup> Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 187, datë 31.10.2022

- Të rivlerësojnë nivelin e treguesit sintetik të përfitimit dhe rrezikut dhe raportimin e tij menjëherë në Autoritet përmes përditësimit të dokumentit me informacionin kryesor për investitorët;
- Të raportojnë në Autoritet rezultatet e stress testeve për fundin e muajit mars 2022, të kryera me qasje më konservatore sesa flukset dalëse të muajve të mëparshëm;
- Të tregojnë kujdes të shtuar në lidhje me nivelin e luhatshmërisë së portofolit dhe nivelin e likuiditetit të SIK;
- Të marrin në konsideratë përputhshmërinë me sanksionet e vendosura nga shteti shqiptar, në aktivitetin për administrimin e SIK.

Autoriteti, kërkon që auditorët dhe organet e brendshme të kontrollit të shoqërive administruese t'i kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve që ndikohen nga kjo situatë, si pjesë e veprimtarisë së tyre audituese për marrëdhëniet financiare.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**